

NË EMËR TË POPULLIT

04.10.18

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, gjyqtari Mehmet Ndrecaj, me procesmbajtësen Shyhare Sopaj, në lëndën penale kundër të akuzuarës B K. nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 të KP - së sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.708/15 të datës 28.07.2017, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor me dt.04.09.2018, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Elfete Purova, të dëmtuarëve S T dhe G Sh. të akuzuarës B K. dhe mbrojtësit av. Kujtim Kërveshi nga Prishtina, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**E akuzuara:**

B K. nga i ati R e ëma F e vajzërisë B e lindur me 1988.1989, në fshatin S komuna e Prizrenit, tani banon në Prizren rr. nr. 10, e martuar, nënë e dy fëmijëve ka të kryer fakultetin e edukimit, e gjendjes së mesme ekonomike, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës me nr. të ID

**ËSHTË FAJTORE**

Se me datë 28.02.2015, rrëth orës 08:40 minuta, në autostradën drejtimi -Prishtinë, në kilometrin e 42, nga pakujdesia rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve dhe pasurinë, si pjesëmarrës në komunikacionin rrugor, duke drejtuar automjetin e markës "Opel Corsa, me targa të regjisitritimit", vepron në kundërshtim me rregullat e komunikacionit, në atë mënyrë që nuk i'a përshtat shpejtësinë e lëvizjes së automjetit, kushteve, gjendjes dhe rrethanave në rrugë, me qëllim të ndaljes së automjetit para çdo pengese, në atë mënyrë që kur vije në vendin kritik, humb kontrollin ndaj automjetit ku fillimisht goditet rrëshqitazi në anësoren e majtë ndarëse të rrugës, e më pas del jashtë rruge në anën e djathtë, duke u rrokuallisur, ku si pasojë pos dëmeve materiale në automjet, lëndim të rëndë trupor pëson bashkëudhëtarja S T dhe atë: traumë e shumëfisht, ndrydhje të indeve të buta të kokës, krahërorit, shpinës dhe paraparez komplete, thyerje e unazave trakale Th hematomiel i modules spinale, grumbullim gjaku në dy zgavarat e krahërorit, shtatzënë në muajin e pestë, ndërhyrje kirurgjike në boshtin kurrizor dhe abort me indikacion mjekësor, ndërsa lëndime të lehta trupore pëson bashkëudhëtarja G Sh. dhe atë: ndrydhje të indeve të buta të krahërorit regionit të barkut dhe kërcinjëve.

**Kështu që ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 8 lidhur me par. 6 të KP-së.**

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 6, 7, 17, 41, 42, 49 paragr.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, të KP-së, të akuzuarës i'a shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Duke ja vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara brenda kohës së verifikimit prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Të dëmtuarat: S \_\_\_\_\_ T \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. \_\_\_\_\_ nr. 11 dhe G \_\_\_\_\_ Sh \_\_\_\_\_ nga Prizreni rr. \_\_\_\_\_ pa.nr, për realizimin e kërkesës përsiore juridike udhëzohen në kontestin civil.

Obligohet e akuzuara që t' i paguajë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë ato sipas llogarisë së arkës së kësaj gjykate dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumën prej 40.88 euro, për ekspertizën mjekoligjore shumën prej 50 euro, për kompezimin e viktimate të krimtit shumën prej 30 euro, si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 50 euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

### Arsy etim

Prokuroria Themelore në Prizren, ka paraqitur aktakuzë PP.nr.708/15 të datës 28.07.2017, kundër të akuzuarës B \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ nga Prizreni, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par.8 lidhur me par. 6 të KP-së, ndërsa me dt.04.09.2018, është paraqitur edhe marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata gjatë seancës gjyqësore ka dëgjuar prokurorin të dëmtuarat, mbrojtësin dhe të akuzuarën.

Prokurori i Shtetit- Elfete Purova gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë ka deklaruar se: më datë 04.09.2018 sipas autorizimit të kryeprokurorit të PTH në Prizren dhe me propozim të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, kemi lidhur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në PTH në Prizren, i akuzuarit është pajtuar me dënimin e propozuara nga PTH, andaj mbes në marrëveshjen e lidhur me dt. 04.09.2018.

Mbrojtësi i të akuzuarës B \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_, av. Kujtim Kërveshi nga Prishtina gjatë seancës ka deklaruar se: qëndroj pranë marrëveshjes së arritur sot pranë Prokurorisë Themelore në Prizren, marrëveshja është arritur në përputhje me dispozitat e KPP -së, me vullnetin e lirë, pa shtytje, pa rrethana tjera të cilat kishin për ta penguar arritjen e kësaj marrëveshje. E pandehura B \_\_\_\_\_ është në lidhje familjare me të dëmtuarën, për të cilën edhe është thirrur në përgesgjësi penale, rrethana këto të cilat kanë bërë që ajo të ndjehet edhe më e përgjegjshme, për jo vetëm pasojat, por edhe përbazën e përgjegjësisë për të dëmtuarat.

E akuzuara B \_\_\_\_\_ K \_\_\_\_\_ është pajtuar me deklratën e mbrojtësit të saj.

Të dëmtuarat: S \_\_\_\_\_ T \_\_\_\_\_ dhe C \_\_\_\_\_ Sh \_\_\_\_\_ kanë deklaruar se: nuk i bashkëngjitem ndjekjes penale, do të parashtojmë kërkësë pausrore-juridike.

Gjykata pas dëgjimit të pikëpamjeve të prokurorit të shtetit, të dëmtuarëve mbrojtësit dhe të kuzuarës, lidhur me pranimin e fajësisë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë konstatoi se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga e akuzuara pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, e akuzuara nuk kanë qenë e detyruar ose e shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë pranimi i fajësisë -

mbështetet në fakte dhe prova materiale të rastit konkret të cilat paraqiten në aktakuzë të pranuara edhe nga e akuzuara dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrëthanat që parashihen me dispozitat e nenit 253 par.1 dhe 2 të KPP-së për hudhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuara, formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuaren t'a shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të saj.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka dëgjuar deklaratat e të gjitha palëve dhe ka pranuar dënimin e propozuar sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë duke marrë parasysh edhe rrëthanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke marrë parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarëst, intenzitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur.

Prej rrëthanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar *pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarës sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, se ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur, në gjykim ka pasur qëndrim korrekt, me të dëmtuarët është në marrëdhënie familjare dhe tanë raportet i kanë regulluar*. Ndërkaq si rrëthana rënduese është vlerësuar, *mënyra dhe rrëthanat e kryerjes së veprës, rrezikshmëria shoqërore e veprës penale e cila mund të kishte përfunduar edhe me fatalitet*, andaj gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të shqiptimit, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 të KP-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrëthanat personale të cilat i posedon e akuzuara.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450, 451 par.1 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pasurore-juridike është marrë konfrom nenit 463 par. 2 të KPP-së.

Vendimi për programin e kompensimit të viktimate të krimtit është marrë në kuptim të nenit 39 parag.3 pika 1 të Ligjit me numër 05/L-036.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.1586/17, me datë 04.09.2018**

**Procesmbajtësja**  
**Shyreste Sopaj**



**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi palët nuk kanë të drejtë e ankesës për shkak të vendimit mbi dënimin dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa për bazat tjera mund të ushtrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë.